



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.235/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit (KVV), Podujevë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa ZL.Anr.235/2025, e datës 16.10.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit (KVV), Podujevë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Podujevë, për Zgjedhjet Lokale të datës 12.10.2025, ashtu që **urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që kutia e votimit Nr.1807/02, të rinumërohet dhe të përfshihet në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025 në Qendren e Votimit 1807 SH.F. "Ibrahim Rugova" në vendvotimin nr.2 në Podujevë ka ndodhur një shkelje flagrante dhe keqpërdorim i votës. Këtë shkelje parashtruesi i ankesës thekson se e kanë vrejtur në QKN kur kanë ardhur kutitë për verifikim/numërim më datë 15 Tetor 2025, kur është hapur kutia e votimit 1807/02 ka pasur mospërputhje në mes të formularëve dhe gjendjes reale të fletëvotimeve në kutitë e votimit. Tutje, ankuesi sqaron se gjendja reale në kuti të votimit ishte 402 fletëvotime ndërsa në listën përfundimtare të votuesve janë 399 nënshkrime që domethënë dallimi është 3 vota dhe sipas rregullores së KQZ-së numri i fletëvotimeve në kuti duhet të jetë i njëjtë me numrin e nënshkrimeve në Listën Përfundimtare të Votuesve në atë vendvotim (LPV), nuk lejohet asnjë votë në kuti më shumë sesa nënshkrime në listën përfundimtare të votuesve në një vendvotim. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës shton se në dy kutitë e votimit si për Kryetar Komune dhe për Kuvend Komunal për Podujevë janë gjetur nga 4 fletëvotime të pavulosura që shtojnë me shumë dyshime për keqpërdorim. Andaj,

kërkojmë nga PZAP që të merret me rastin dhe keqpërdoruesit e detyrës zyrtare të marrin dënimin.

Si prova,parashtruesi i ankesës në ankesë ka bashkangjitur: Fletëvotimin për Kandidatët për Kryetarë të Komunave nga Vendvotimi 1807-02 , Fletëvotimin për Kandidatët për Kuvendin Komunal nga Vendvotimi 1807-2 dhe Fletëvotimin për Subjektet Politike nga Vendvotimi 1807-2 .

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LDK me të cilat pretendon se ka pasur mospërputhje mes listës së nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutinë e votimit, se ka qenë nga një votim më pas në kutinë e votimit për dallim nga lista e nënshkrimeve në fletëvotimet 1807/2, në Komunën e Podujevës, paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit është vërtetuar se ka pasur mospërputhje.

Nga hetimi i kryer nga ana e ekipit hetues të PZAP-it, me datën 17.10.2025 është konstatuar kjo gjendje faktike: në vendvotimin 1807/02, kanë qenë 399 nënshkrime në Listën e Votuesve dhe 402 fletëvotime në kutinë e votimit.Po ashtu, Paneli gjatë hetimeve të kryera ka konstatuar se në vendvotimin 1807/02 po ashtu kanë qenë 298- fletëvotime të papërdorura; 0- fletëvotime të dëmtuara/të pavlefshme, 16- numri i fletëvotimeve të zbrazëta/të pavlefshme (brenda kutisë).

Andaj nga kjo gjendje faktike, Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendrës Komonale të Numërimit (QKN), në vendvotimin 1807/02 në Podujevë prej 399 nënshkrimeve në Listën e Votuesve, në kutinë e votimit janë gjetur 402 fletëvotime.

Në bazë të lartcekurave paneli vlerëson se në vendvotimin 1807/02 janë (3) fletëvotime më shumë se në listën e nënshkrimeve,e cila është në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 105 i LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht thotë *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”,* si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13 *“në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme :12.1. të urdhëroje KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi.”*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli duke u mbështetur në nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, konstaton se në rastin konkret ka mospërputhje në këtë kuti votimi.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 105 , neni 118 par. 1 të LZP-së Nr.08/L-228, lidhur me nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.235/2025, datë 17.10.2025

Kryesues i Panelit
Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.